

LIGJ
Nr.8432, datë 14.12.1998

PËR AZILIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
(Ndryshuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

(I përditësuar)

Në mbështje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1 dhe 2 me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Me këtë ligj Republika e Shqipërisë u njeh të drejtën për azil ose mbrojtje plotësuese të gjithë të huajve që kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, qofshin këta refugjatë apo persona të tjerë dhe që kërkojnë azil në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

2. Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për dhënien dhe heqjen e azilit në Republikën e Shqipërisë, si dhe të drejtat e detyrat e refugjatëve dhe të personave nën mbrojtje të plotësuese.

Neni 1/1

Përkufizime

(Shtuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Konventa e Gjenevës” është konventa për statusin e refugjatëve, e datës 28 korrik 1951, e ndryshuar me protokollin e Nju Jorkut, të datës 31 janar 1967.

2. “Azil” është mbrojtja që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve ose personave në mbrojtje plotësuese.

3. “Kërkesa për azil” është çdo deklaram i bërë me shkrim, me gojë apo me gjeste, nga një shtetas i huaj ose një person pa shtetësi, para organeve kompetente, në kufi apo brenda vendit, e cila vlerësohet si një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, sipas konventës së Gjenevës. Çdo kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare vlerësohet kërkesë për azil, përveç rastit kur një shtetas i huaj ose pa shtetësi kërkon qartazi një lloj tjetër mbrojtjeje, për të cilën aplikohet veçmas.

4. “Aplikimi për azil” është kërkesa zyrtare, drejtuar Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët, në përputhje me procedurat e parashikuara në këtë ligj.

5. “Azilkërkuar” është çdo shtetas i huaj ose person pa shtetësi, i cili shpreh me çfarëdolloj mënyre se nuk dëshiron të kthehet në vendin e vet dhe ka bërë një kërkesë për azil në Republikën e Shqipërisë, për të cilën nuk është marrë ende një vendim përfundimtar.

6. “Refugjat” është shtetasi i huaj apo personi pa shtetësi që, për shkak të frikës së bazuar të persekutimit, për arsye të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose bindjes politike, ndodhet jashtë vendit të shtetësisë së vet dhe nuk ka mundësi, ose për shkak të një frike të tillë, nuk ka dëshirë të kërkojë mbrojtjen e atij vendi, ose

kur ai, duke mos pasur një shtetësi dhe ndodhet jashtë vendit të mëparshëm të banimit të zakonshëm të tij, si pasojë e këtyre ngjarjeve, nuk ka mundësi ose nuk ka dëshirë të kthehet atje, për arsye të kësaj frike, në përputhje me kriteret e nenit 1(A) të konventës së Gjenevës.

7. "Statusi i refugjatit" është statusi që i jepet personit, i cili është njohur si refugjat nga organi përkatës dhe është i pranuar si i tillë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. "Të mitur të pashoqëruar" janë shtetasit e huaj apo personat pa shtetësi nën 18 vjeç, të cilët vijnë në territorin e Republikës së Shqipërisë të pashoqëruar nga një person madhor, përgjegjës për ta, sipas ligjit ose sipas traditës dhe për sa kohë ata nuk janë efektivisht nën kujdesin e një personi të tillë. Këtu përfshihen edhe të miturit, të cilët janë lënë të pashoqëruar, pasi kanë hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

9. "Mbrojtje e përkohshme" është një procedurë e veçantë mbrojtjeje, e cila u siguron mbrojtje të menjëhershme dhe të përkohshme personave të shpërngulur nga vendet e tjera, në rastet e flukseve masive, të cilët nuk mund të kthehen në vendin e tyre të origjinës, në veçanti, nëse ekziston rreziku, që sistemi i azilit të jetë i paaftë të procedojë me këtë fluks, pa efekte të pafavorshme në zhvillimin e tij efektiv, në interes të personave të interesuar dhe personave të tjerë që kërkojnë mbrojtje.

10. "Fluks masiv" është arritja në territorin e Republikës së Shqipërisë e një mase të madhe të personave të shpërngulur, të cilët vijnë nga një shtet apo zonë gjeografike e caktuar, qoftë edhe nëse ardhja e tyre ka qenë spontane apo e ndihmuar nga një program evakuimi.

11. "Heqja e statusit të refugjatit" është vendimi i marrë nga organi përkatës për revokimin dhe/ose refuzimin për përtëritjen e statusit të refugjatit.

12. "Forma plotësuese e mbrojtjes" është forma e mbrojtjes, që i jepet të huajit, i cili, megjithëse nuk përmbush kriteret e të qenit refugjat, siç është shprehur në këtë nen të këtij ligji, nuk do t'i nënshtrohet asnjë urdhri dëbimi apo përzënieje, të lëshuar nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, nisur nga arsyet përkatëse, të shprehura në konventën europiane "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" të vitit 1950, në konventat e Kombeve të Bashkuara kundër torturës, në ato për të drejtat civile dhe politike dhe çdo instrument tjetër ndërkombëtar, ku Republika e Shqipërisë është ose do të jetë palë.

Neni 2

Azili

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Neni 3

Azilkërkues

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Neni 4

Refugjati

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Neni 5

Personat nën mbrojtje të përkohshme për arsye humanitare

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Neni 5/1

Mbrojtja e përkohshme në rastet e fluksit masiv

(Shtuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Në rastet e një fluksi masiv të personave të huaj, që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në territorin shqiptar, procedurat e parashikuara në kreun IV të këtij ligji, për shqyrtim individual të kërkesave për azil, mund të pezullohen, duke u dhënë të gjithë personave të një grupi mbrojtje të përkohshme. Kjo mbrojtje jepet nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët për një afat të përcaktuar në vendimin që del për këtë qëllim.

Neni 6

Dhënia e azilit mbi bazën e parimit të bashkimit familjar

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 1, 2 dhe 3 me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Të drejtën e azilit, me të njëjtin status, e përfitojnë edhe bashkëshorti, fëmijët e moshës nën 18 vjeç dhe çdo i afërm në ngarkim ligjor të të huajit, të cilit i është dhënë azil, me kusht që ata të banojnë së bashku.

2. Personi mbi moshën 18 vjeç nuk mund të përfitojë azil në bazë të zbatimit të parimit të bashkimit familjar, sipas paragrafit 1 të këtij neni, veç në rastet kur ai/ajo është në ngarkimin ligjor të prindërve të tij ose të huajve të tjerë të cilëve iu është dhënë azil në Republikën e Shqipërisë. Ai/ajo duhet të paraqesë kërkesë individuale për azil në rast se dëshiron t'i ofrohet azil në Republikën e Shqipërisë

3. Në rastin e zgjidhjes së martesës, ndarjes apo vdekjes së të huajit që ka përfituar azil, anëtarët e familjes që kanë përfituar azil në përputhje me paragrafin e parë të këtij neni, do të vazhdojnë të gëzojnë të drejtën e azilit. E njëjta gjë zbatohet për fëmijët që gëzojnë azil në përputhje me parimin e bashkimit familjar, kur ata mbushin moshën 18 vjeç.

Neni 7

Moskthimi

(Ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Në kuptim të këtij ligji, pavarësisht nga zbatimi i neneve 8 dhe 9, Republika e Shqipërisë njeh dhe respekton detyrimin për të mos kthyer dhe larguar jashtë territorit të vet, personat që kanë përfituar apo kërkuar të drejtën e azilit apo të formave të tjera të mbrojtjes në këto raste:

a) Në një shtet ku jeta apo liria e tyre kërcënohen për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo të bindjeve politike;

b) në një shtet ku ata do t'i nënshtrohen torturës dhe trajtimit a ndëshkimit çnjerëzor e poshtërues, ose çdo trajtim tjetër të parashikuar në traktatet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë;

c) në shtetin e tyre të origjinës, në rast se atyre u është dhënë një nga format e mbrojtjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ç) në një shtet të tretë, i cili mund të kthejë a dërgojë personin në një nga shtetet e treguara në pikat "a" dhe "b" të këtij neni.

2. Azilkërkuesi, të cilit kërkesa për azil i është refuzuar nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, nuk dëbohet a kthehet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përpara nënshkrimit a dhënies së mundësive ligjore për ushtrimin e të drejtave procedurale dhe garancive të parashikuara në këtë ligj.

Neni 8

Pushimi dhe heqja e azilit

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Refugjatit, i cili e ka përfituar azilin në përputhje me këtë ligj, mund t'i hiqet kjo e drejtë, si rrjedhojë e pushimit të statusit të refugjatit, në njërin nga rastet e mëposhtme:

a) kur kërkon, me vullnetin e vet, mbrojtjen e shtetit ku gëzon shtetësinë;

b) kur rimerr, me vullnetin e vet, shtetësinë, të cilën e kishte humbur;

c) kur fiton një shtetësi të re dhe gëzon mbrojtjen e shtetit të shtetësisë së re;

ç) kur rivendoset, me vullnetin e vet, në shtetin nga ku është larguar ose jashtë të cilit ka qëndruar për motive persekutimi;

d) kur kanë pushuar së ekzistuari rrethanat e parashikuara në pikën 6 të nenit 1/1 të këtij ligji dhe nuk ka arsye për të refuzuar mbrojtjen e shtetit të shtetësisë së vet;

dh) kur është person pa shtetësi dhe kanë pushuar së ekzistuari rrethanat, për të cilat i është dhënë e drejta e azilit, si dhe i ka mundësitë e kushtet për t'u rikthyer në shtetin nga ku ishte larguar.

2. Përgjegjësia për mbrojtjen ndërkombëtare të personave të njohur si refugjatë, në

përputhje me konventën e Gjenevës dhe protokollin e vitit 1967, në Republikën e Shqipërisë mund të vlerësohet si e transferuar në një shtet të tretë, palë në instrumentet e lartpërmendura ndërkombëtare, në rast se ky i fundit ka pranuar që refugjati të qëndrojë si i tillë në territorin e tij, në mënyrë të vazhdueshme dhe ka njoftuar Republikën e Shqipërisë për këtë veprim.

3. Pushimi i azilit bëhet duke zbatuar të njëjtat procedura të parashikuara edhe për dhënien e tij.

4. Refugjatit, i cili e ka përfituar azilin, në përputhje me pikën 6 të nenit 1/1 të këtij ligji, mund t'i hiqet kjo e drejtë, jo vetëm si rrjedhojë e pushimit të statusit të refugjatit, por edhe si dënim plotësues, i dhënë nga gjykata, për ta nxjerrë të huajin nga territori i Republikës së Shqipërisë për vepra penale, për të cilat parashikohet një dënim me jo më pak se 10 vjet heqje lirie, nga dispozitat penale në fuqi në çastin e dhënies së vendimit përfundimtar, me arsyetimin, në vendim, nga gjykata se personit, të cilit i hiqet azili, nuk do t'i kërcënohen, në vendin e vet, të drejtat e parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

Përjashtimi nga e drejta për azil

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Shtetasit e huaj apo personat pa shtetësi, që ndodhen në Republikën e Shqipërisë, përjashtohen nga e drejta për azil, në rastin kur ka prova të mjaftueshme se:

a) kanë kryer krim kundër paqes, krim lufte apo kundër njerëzimit, sipas përcaktimeve të parashikuara në konventat ndërkombëtare;

b) përbëjnë një rrezik për rendin publik dhe sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë, për shkak të kryerjes së një krimi të rëndë jopolitik jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;

c) janë fajtorë për veprime, që bien ndesh me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

Neni 10

Kërkesa dhe aplikimi për azil

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

KREU II

TË DREJTAT DHE DETYRIMET

Neni 11

Detyrimet e azilkërkuesve dhe të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Azilkërkuesi apo personi, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, ndalohet të angazhohet në veprimtari të tilla, që krijojnë probleme për rendin publik, cenojnë sigurinë kombëtare dhe mund të ndikojnë në marrëdhëniet e Republikës së Shqipërisë me vendet e tjera.

2. Azilkërkuesi apo personi, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë, nuk duhet të veprojë kundër parimeve dhe qëllimeve, që burojnë nga traktatet dhe konventat e OKB-së, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3. Azilkërkuesi duhet të japë çdo informacion, për të cilin mendohet se ai ka dijeni, kur i kërkohet nga autoritetet e azilit dhe që shërben për marrjen e një vendimi, të bazuar dhe të drejtë, për aplikimin e tij për azil.

4. Azilkërkuesi duhet të jetë në dispozicion të autoriteteve të azilit gjatë të gjithë procedurës për azil.

Neni 12

Të drejtat e refugjatëve

(Ndryshuar fjalë e dytë e pikës 2 dhe pika 3 me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. I huaji, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë gëzon status ligjor në përputhje me legjislacionin shqiptar, me Seksionin e Aktit Final të Konferencës së Plotfuqishmëve, me Konventën e OKB-së së vitit 1951 "Për statusin e refugjatëve" dhe me traktatet e tjera ndërkombëtare ku Shqipëria është palë, si dhe të gjitha të drejtat që legjislacioni shqiptar iu njeh të huajve.

2. Refugjati që përfiton azil pajiset me lejeqëndrimi dhe me leje pune të posaçme. Ai gëzon të gjitha të drejtat, që u njihen refugjatëve nga ky ligj dhe nga ligji nr.9098, datë 3.7.2003 "Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave, që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë".

3. Refugjatët, që përfitojnë të drejtën e azilit në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me normat e përcaktuara në nenin 28 të konventës së Gjenevës, pajisen nga Ministria e Brendshme me dokument udhëtimi. Ky dokument, për aq kohë sa është i vlefshëm, mund të përdoret për të udhëtuar në të gjitha shtetet, me përjashtim të shtetit të origjinës dhe për t'u rikthyer në Shqipëri.

Neni 13

Të drejtat e personave që u është dhënë mbrojtje plotësuese

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Çdo i huaj, i cili përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe që i është dhënë mbrojtje plotësuese individualisht nga autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, përfiton të drejtat e parashikuara në këtë ligj, të cilat u jepen refugjatëve, në përputhje me konventën e Gjenevës, përveç dokumentit të udhëtimit.

Neni 14

Të drejtat e personave, që u ofrohet mbrojtje e përkohshme, si pasojë e situatave të flukseve masive

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Çdo i huaj, të cilit i është dhënë mbrojtje e përkohshme, si pasojë e situatave të flukseve masive, gëzon të drejtat që u jepen refugjatëve, përveçse kur ato kufizohen nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, siç është parashikuar në këtë ligj.

Neni 15

Të drejtat e azilkërkuesve

(Ndryshuar togfjalësh dhe shkronja "b" e pikës 2, me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Azilkërkuesi do të trajtohet në përputhje me dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar që rregullon statusin e të huajve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj.

2. Azilkërkuesit do t'i garantohet:

a) e drejta e moskthimit sipas nenit 7 të paragrafit 2 të këtij ligji;

b) e drejta e strehimit, e ushqimit, e ndihmës financiare për nevoja ngushtësisht vetjake, të ofruara në qendrën kombëtare pritëse për azilkërkuesit.

Neni 16

Ndalimi i azilkërkuesve

(Ndryshuar togfjalësh dhe fjalë me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Azilkërkuesit që hyjnë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk do të ndiqen penalisht për kalim të paligjshëm të kufirit, me kusht që ata të paraqiten përpara autoriteteve përkatëse jo më vonë se 10 ditë nga dita e kalimit të paligjshëm të kufirit.

2. Azilkërkuesit, të cilët paraqiten brenda afatit, mund të ndalohen vetëm për arsye të mëposhtme:

- a) Për verifikimin e identitetit të tyre;
- b) kur kanë zhdukur dokumentet e identitetit apo të udhëtimit ose janë pajisur me dokumente të rreme, për të mashtruar autoritetet përkatëse;
- c) për të është lëshuar një mandat arresti ndërkombëtar;
- ç) për mbrojtjen e sigurisë kombëtare dhe të rendit publik.

3. Masat shtrënguese ndaj një azilkërkuesi merren në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast azilkërkuesit i garantohet kontaktimi me UNHCR-në dhe ushtrimi i të drejtave procedurale penale.

4. Në rast ndalimi e arrestimi, nëse është e mundur, azilkërkuesi mbahet në izolim, i veçuar nga personat e tjerë, përveç kur këto masa shtrënguese merren në bazë të pikës 2, shkronja "b" e këtij neni.

5. Në përputhje me normat ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve, të cilat Republika e Shqipërisë i ka ratifikuar, kur është fjala për azilkërkuesit e mitur të pashoqëruar nën moshën 18 vjeç, këta nuk burgosen, përveçse në raste ekstreme. Në çdo rast tjetër ndaj tyre merren masat e duhura dhe të përshtatshme për fëmijët.

KREU III AUTORITETET E AZILIT

Neni 17

Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme përbëhet nga drejtori, zëvendës drejtori dhe të paktën tre specialistë, të cilët janë përgjegjës për regjistrimin e aplikimeve, drejtimin e dëgjimeve dhe grumbullimin e të dhënave të tjera, të nevojshme për plotësimin e dokumentacionit për çdo aplikim për azil.

2. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët është i vetmi autoritet për dhënien, heqjen dhe përjashtimin nga e drejta e azilit.

3. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët është përgjegjëse për zbatimin e masave që duhen marrë për mbrojtjen dhe ndihmën që u ofrohet azilkërkuesve dhe refugjatëve. Autoritetet përkatëse bashkëpunojnë me Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët për zbatimin e rregullave dhe të procedurave të nevojshme për dhënien e të drejtave, që u takojnë azilkërkuesve dhe refugjatëve.

4. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët administron fondet publike, të dhëna në buxhet, si dhe ndihmat e tjera financiare ose materiale për azilkërkuesit dhe refugjatët, të ofruara nga organizatat vendase apo ndërkombëtare.

5. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët është organizmi drejtues në rastet e flukseve masive dhe, nën drejtimin e drejtorit të saj, organizon punën për trajtimin e personave që u ofrohet mbrojtje e përkohshme. Ajo është përgjegjëse, në mënyrë të veçantë, për regjistrimin, sistemimin dhe shpërndarjen e ushqimeve personave që u është dhënë mbrojtje e përkohshme.

Neni 18

Komisioneri Kombëtar për Refugjatët

(Ndryshuar togfjalësh dhe pika 4 dhe shfuqizuar pikat e dhe 3 me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Komisioneri Kombëtar për Refugjatët është Drejtori i Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët.

2. Shfuqizuar.

3. Shfuqizuar.

4. Komisionari kombëtar për refugjatët merr të gjitha masat e nevojshme ose i drejtohet gjykatës për të caktuar, për çdo fëmijë azilkërkues të pashoqëruar apo person të rritur, me të meta mendore, një kujdestar, në përputhje me legjislacionin shqiptar për përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të tyre.

5. Komisioneri Kombëtar për Refugjatët inicion me zyrën për refugjatët procedurën për heqjen e azilit, në rast se ka arsye të bazuara, për të menduar se refugjati në fjalë përfshihet në klauzolat për heqjen e azilit, të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji.

6. Komisioneri Kombëtar për Refugjatët mbikëqyr regjistrimin e personave që u është dhënë mbrojtje e përkohshme, si dhe bashkërendon ndihmat e ofruara nga autoritetet vendore dhe organizatat ndërkombëtare.

7. Komisioneri Kombëtar për Refugjatët drejtohet nga udhëzimet e lëshuara nga ministri përkatës.

Neni 19

Komisioni Kombëtar për Refugjatët
(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Neni 20

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)
(Ndryshuar togfjalësh në pikën 2 dhe hequr togfjalësh në pikën 3 dhe 4 me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Azilkërkuesit, refugjatët dhe personat nën mbrojtje të përkohshme kanë të drejtë të kontaktojnë me zyrën e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR). Përfaqësuesit e UNHCR-së kanë të drejtë të takohen me çdo azilkërkues, refugjat apo person nën mbrojtje të përkohshme, që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët dërgon pranë UNHCR-së informacionin e nevojshëm për azilkërkuesit e regjistruar dhe në mënyrë të veçantë i mundëson UNHCR-së, në bazë të kërkesës, shqyrtimin e dosjeve individuale të azilkërkuesve dhe refugjatëve. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët i dërgon UNHCR-së listën e aplikimeve që shqyrtohen nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, si dhe të apelimeve janë paraqitur me synimin për të siguruar bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve vendase me UNHCR-në në përputhje me nenin 35 të Konventës së Gjenevës së vitit 1951 "Për Statusin e Refugjatëve".

3. UNHCR-ja mund t'u ofrojë zyrës së refugjatëve propozime me karakter të përgjithshëm, si dhe rekomandime për raste të veçanta, apo të flukseve masive.

4. UNHCR-ja mund të marrë pjesë me statusin e vëzhguesit në mbledhjet e zyrës për refugjatët, që kanë të bëjnë me përcaktimin e statusit të refugjatit.

KREU IV
PROCEDURA E AZILIT

Neni 21

Kërkesa për azil
(Ndryshuar fjalë dhe togfjalësh në pikën 1 dhe 2 me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Të huajt që dëshirojnë të kërkojnë azil në Republikën e Shqipërisë duhet:

a) T'u drejtohen organeve kompetente në kufi apo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të paraqesin kërkesën për azil;

b) T'i drejtohen drejtpërdrejt zyrës për refugjatët dhe të plotësojnë dhe aplikimin për azil në përputhje me formularët e miratuar nga Ministria e Brendshme.

2. Në rastet kur i huaji kërkon azil në përputhje me shkronjën "a", të pikës së parë të

këtij neni, organet kompetente bëjnë njoftimin dhe dërgimin e menjëhershëm të tij në zyrën për refugjatët në Tiranë, në mënyrë që të regjistrohet dhe të plotësojë aplikimin për azil.

Neni 22

Identiteti i azilkërkuesve

(Ndryshuar togfjalësh dhe pika 2 e shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Autoritetet që dërgojnë azilkërkuesin në zyrën për refugjatët, ashtu si dhe vetë Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, janë përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme për të përcaktuar të dhënat personale të azilkërkuesit.

2. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët mund t'i drejtohet me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për vërtetimin e sa më sipër. Në një rast të tillë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i kthen përgjigje Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët brenda një afati 15-ditor.

3. Shfuqizuar.

Neni 23

Aplikimi për azil

(Ndryshuar togfjalësh dhe pika 3 me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Aplikimi për azil plotësohet me shkrim, në gjuhën shqipe apo në njërën prej gjuhëve zyrtare të Kombeve të Bashkuara, zyrës për refugjatët. Aplikimi, përveç identitetit duhet të përmbajë dhe shkaqet për të cilat azilkërkuesi kërkon mbrojtje në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Në zyrën për refugjatët azilkërkuesi është i detyruar të paraqesë të gjitha të dhënat personale dhe të mbushë të gjithë formularët që përgatiten nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët.

3. Në kohën e plotësimit të aplikimit për azil, Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët vë në dijeni azilkërkuesin për procedurat e përcaktimit të statusit të refugjatit. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët mundëson kontaktin e azilkërkuesit me një përfaqësues ligjor, specialist në çështjet e refugjatëve, për shërbime ligjore falas.

4. Për periudhën deri në dhënien e vendimit përfundimtar, lidhur me aplikimin për azil, azilkërkuesi lejohet të qëndrojë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 24

Detyrimet për bashkëpunim

(Ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Azilkërkuesi është i detyruar të bashkëpunojë për saktësimin e fakteve të parashtruara prej tij për aplikimin për azil. Ai është i detyruar:

a) të japë informacionin e nevojshëm, gojarisht apo me shkrim, sipas kërkesës së autoriteteve të azilit;

b) t'u paraqesë dhe t'u dorëzojë autoriteteve përkatëse të gjitha dokumentet që disponon, të nevojshme për vlerësimin e kërkesës së tij për azil;

c) të jetë i kontaktueshëm, sipas kërkesës së autoriteteve dhe t'i njoftojë ato menjëherë për mundësitë e tij për të kontaktuar.

2. Azilkërkuesi informohet mbi faktin se informacionet që ai /ajo jep do të mbahen konfidenciale dhe shërbejnë si bazë për marrjen e vendimit, e për rrjedhim ato duhet të jenë të vërteta dhe të sakta.

Neni 25

Përkthyesit

1. Në rast se azilkërkuesi nuk ka njohuri të mjaftueshme të gjuhës shqipe, atij i jepet një përkthyes i kualifikuar në mënyrë që të komunikojë lirishëm në të gjitha fazat e procedimit të parashikuara në këtë ligj.

2. Azilkërkuesi ka të drejtë të zgjedhë, me shpenzimet e veta, një përkthyes tjetër.

Neni 26

Dëgjimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Azilkërkuesi dëgjohe për aplikimin e tij për azil në Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët. Azilkërkuesi njoftohet me shkrim për datën e dëgjimit, e cila nuk mund të jetë më vonë se 21 ditë nga data kur ka plotësuar aplikimin në Drejtorinë për Shtetësinë dhe Refugjatët.

2. Azilkërkuesi mund të pyetet për faktet dhe ngjarjet e deklaruar gjatë dëgjimit, kur ka paqartësi në ato që ka thënë ai apo në informacionet e mbledhura nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, brenda një periudhe prej jo më vonë se 20 ditësh nga data e dëgjimit. Data e dëgjimit i njoftohet me shkrim.

3. Azilkërkuesi, në çdo fazë të procedurës, shoqërohet, këshillohet apo përfaqësohet nga një përfaqësues ligjor, specialist në çështjet e refugjatëve.

4. Azilkërkueset e seksit femër, nëse është e mundur, dëgjohe dhe pyeten nga punonjëse femra të personelit të Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët. Edhe përkthyesja, nëse është e mundur, duhet të jetë femër. Fëmijët azilkërkues, të pashoqëruar, dëgjohe dhe pyeten në prani edhe të një psikologu apo të një të rrituri, që njeh mirë natyrën e fëmijës apo që gëzon besimin e tij.

5. Azilkërkuesi shpjegon faktet, ku mbështeten arsyet dhe motivet për persekutimin e tij apo për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe ofron të dhënat e nevojshme, ku përfshihen informacioni për vendin e rezidencës, për itinerarin, ndalesat në vendet e tjera dhe kërkesat e mundshme për azil në vende të tjera, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për sqarimin e rrethanave të çështjes.

6. Dëgjimi mund të ndiqet edhe nga një përfaqësues i UNHCR-së.

Neni 26/1

Konfidencialiteti

(Shtuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Dëgjimi nuk bëhet publik. Azilkërkuesit i shpjegohet detyrimi ligjor i atyre që njihen me informacionet e dhëna prej tij, për ta ruajtur informacionin si konfidencial. Atij i garantohet konfidencialiteti i dëgjimit.

Neni 27

Procedurat në zyrën për refugjatët

(Ndryshuar togfjalësh në pikën 2, 3, 5 dhe 6 dhe pika 4 me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët regjistron të gjitha të dhënat e rëndësishme ofruar nga azilkërkuesi. Kur aplikimi për azil të jetë plotësuar me të gjitha të dhënat dhe formularët e nevojshëm, Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët i jep azilkërkuesit një dokument, ku vertetohet identiteti i tij dhe pranimi i aplikimit për azil, duke e garantuar për moskthimin e tyre, në përputhje me paragrafin e katërt, të nenit 23 të këtij ligji.

2. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët drejton dëgjimin, verifikon faktet e dhëna dhe plotëson dokumentacionin e nevojshëm para marrjes së vendimit. Në dosje vendoset edhe rekomandimi i dhënë nga UNHCR-ja për aplikimin për azil.

3. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët e mbështet vendimin e vet në deklaratimet përkatëse të refugjatit, të marra sipas parashikimeve të këtij ligji. Drejtoria për Shtetësinë dhe

Refugjatët, në marrjen e vendimit mbështetet në parimin e besueshmërisë dhe në prezumimin që azilkërkuesi ka të drejtë. Ajo, gjithashtu, merr parasysh rekomandimet e paraqitura nga UNHCR-ja.

4. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët merr vendim brenda 30 ditëve nga data e dëgjimit të azilkërkuesit dhe u jep, pa vonesë, si azilkërkuesit dhe UNHCR-së, një kopje të vendimit, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit. Vendimi i Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët merret në një mbledhje të posaçme. Vendimi i Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët jepet me shkrim dhe duhet të jetë i arsyetuar. Ai merret në mënyrë kolegjiale e, si rrjedhim, procedura e marrjes së vendimit u nënshtrohet dispozitave në fuqi për marrjen e vendimeve në organet kolegjiale. Vendimi merret me shumicë absolute votash. Pjesëtarët e Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët, të cilët janë në pakicë, mund ta shprehin me shkrim mendimin e tyre kundër. Ky mendim me shkrim duhet t'i bashkëlidhet vendimit përfundimtar.

5. Në rast së aplikimi për azil pranohet, Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët informon azilkërkuesin për kushtet e azilit dhe se azili mund të hiqet vetëm në përputhje me nenin 8 të këtij ligji.

6. Në rast se aplikimi për azil mohohet, Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët informon azilkërkuesin me vendimin e saj të shkruar, individual e të arsyetuar, ku do të shprehet e drejta e tij për ankim në organin, ku mund të paraqitet ky ankim dhe për periudhën brenda së cilës ai mund të përfitojë nga kjo e drejtë.

Neni 28

Pretendimet abuzive dhe dukshëm të pabazuara

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët mund ta vlerësojë një aplikim si "abuziv", kur është vërtetuar, në mënyrë të pakundërshtueshme, se pretendimi i bërë nga azilkërkuesi është i rremë dhe me qëllim për të mashtruar autoritetet.

2. Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët mund ta vlerësojë një aplikim si dukshëm të pabazuar, kur pretendimi i bërë nga azilkërkuesi nuk ka lidhje, në asnjë mënyrë, me kriteret për dhënien e azilit, siç është përcaktuar nga ky ligj.

3. Në rastet kur Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët quan se një aplikim për azil është "abuziv" apo "dukshëm i pabazuar", ajo merr vendim të ndërmjetëm, me shkrim dhe të motivuar, i cili përfshihet në dosjen e azilkërkuesit. Kundër këtij vendimi azilkërkuesi ka të drejtë të bëjë ankim, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj. Si rrjedhim, do të zbatohet procedura e përshpejtuar e vlerësimit të aplikimit. Nëse në fazën e parë të procedurës së përshpejtuar, Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët nuk jep vendim brenda 10 ditëve, aplikimi do të pranohet vetvetiu në procedurën normale të përcaktimit të statusit të refugjatit. Azilkërkuesit i jepet një afat 7-ditor për të ankimuar, nga data kur ai merr vendimin e Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët.

Neni 28/1

Mosdhënia e azilit, si rrjedhojë e ardhjes nga një vend i tretë, i sigurt

(Shtuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Azili mund t'i mohohet çdo të huaji që vjen nga një vend i tretë, i sigurt, palë nënshkruese e konventës së Gjenevës apo protokollit të saj të vitit 1967, vend ku azilkërkuesi nuk mund të paraqesë frikë të bazuar persekutimi, për të paktën për njërën prej arsyeve të përmbajtura në nenin 1 (A) të konventës së Gjenevës, as dhe ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut apo rrezik dëbimi, në kuptimin e dispozitave të këtij ligji dhe, nëse ai mund të kthehet ligjërisht në këtë vend, ku aplikimi i tij për status refugjati do të shqyrtohet në përputhje me standardet ndërkombëtare. Një listë e vendeve të treta, të sigurta, miratohet dhe përditësohet për këtë qëllim vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 29

Apelimi

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Neni 30

Refuzimi dhe dëbimi

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

KREU V

MBROJTJA E PÛRKOHSHME, SI PASOJË E SITUATAVE TË FLUKSIT MASIV

(Ndryshuar titulli me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Neni 31

Të përgjithshme

(Shfuqizuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Neni 32

Të drejtat e të huajve që gëzojnë mbrojtje të përkohshme, si pasojë e situatave të fluksit masiv

(Ndryshuar me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

1. Të huajt, që gëzojnë mbrojtje të përkohshme, si pasojë e situatave të fluksit masiv, pranohen përkohësisht në Republikën e Shqipërisë.

2. Të drejtat e të huajve, që përfitojnë mbrojtje të përkohshme, veçanërisht të drejtën për punë dhe lirinë e lëvizjes, mund të kufizohen, për arsye objektive, nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët gjatë tri viteve të para të qëndrimit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 33

Mundësia për të shfrytëzuar procedurën e azilit

(Ndryshuar fjalë me ligjin nr. 10 060, datë 26.1.2009)

Të huajt, që bëjnë pjesë në grupin e personave që gëzojnë mbrojtje të përkohshme, kanë të drejtën që, me mbarimin e kësaj mbrojtjeje, të paraqesin aplikim individual për azilin, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në këtë ligj.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 34

Anullimi

Neni 22 pika 1 dhe nenet 24, 25, 26, 27 dhe 28 të ligjit nr.7939, datë 25.5.1995 "Për emigracionin", që i referohet azilit në Republikën e Shqipërisë, shfuqizohen.

Neni 35

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2283, datë 28.12.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

